

NJOFTIM

Për regjistrimin në ERE të operatorëve të impianteve të depozitimit të energjisë

Operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë që, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026 "**Për sektorin e energjisë elektrike**", kanë impiante në zhvillim ose në operim dhe **nuk disponojnë licencë të veçantë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë**, janë të detyruar të njoftojnë dhe të regjistrohen pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në përputhje me nenin 51, pikat 3 dhe 5, të këtij ligji.

Afati për regjistrim

Njoftimi , duhet të paraqitet **brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026.**

Si dorëzohet njoftimi ?

Informacioni mund të depozitohet

- në adresën: Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr.7, Tiranë
- në adresën elektronike: erealb@ere.gov.al.

Informacion shtesë

ERE, mbas marrjes se njoftimit mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë, kur kjo vlerësohet e nevojshme për regjistrimin dhe administrimin e Regjistrit të Impianteve të Depozitimit të Energjisë.

Subjektet që plotësojnë kushtet e mësipërme ftohen të respektojnë afatin ligjor për regjistrim.